



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKIAK
GRAMSH

Nr. 3049 / 2 Prot.

Gramsh, më 10 . 08 . 2026

V E N D I M
Nr. 57 , datë 31/07/2026

"Për ndarjen e fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile, për bashkinë Gramsh, për vitin 2026".

Në mbështetje të: ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; nenit 65 të ligjit 45/2019 "Për mbrojtjen civile", VKM nr. 414 datë 8.7.2021 "Për miratimin e procedurave dhe kriterëve për përdorimin dhe shpërndarjen e fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile"; VKB Nr. 105 datë 29.12.2025 "Për miratimin e programit buxhetor të Bashkisë Gramsh, për vitin 2026" si edhe pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur nga Sektori i Emergjencave Civile dhe Strehimit;

V E N D O S I :

1.Miratimin e shpërndarjes së fondit të kushtëzuar në shumën 9,342,128 (nëntë milion e treqind e dyzet e dy mijë e njëqind e njëzet e tetë) lekë, me kod produkti 21AD502 "Rehabilitimi i objekteve të ndryshme infrastrukturore", akorduar nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, si më poshtë

-Mbrojtje Lumore në luginën e Gribës me vlerën 4.000.000 lekë me TVSH.

-Ndërhyrje me tombina në përroin e Shelcanit dhe përroin e Frashërit me vlerën 1.200.000 lekë me TVSH.

-Rikonstruksion i urës në segmentin rrugor Dufshan-Sult me vlerën 1.100.000 lekë me TVSH.

-Rikonstruksion i urës në fshatin Galigat me vlerën 1.200.000 lekë me TVSH.

-Rikonstruksion i urës në Dumberas me vlerën 1.200.000 lekë me TVSH.

-Rikonstruksion i dy urave të këmbësorëve në fshatin Kukur me vlerën 600.000 lekë me TVSH.

2- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Mbrojtjes Civile, Sektori i Emërgjencave Civile dhe Strehimit, Si dhe Drejtoria e Shërbimeve e Mbështetëse dhe Financës.

3- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI I KËSHILLIT

Xhulia GJINI



KRYETARI I KËSHILLIT

Enis ZANI

